

dt 29-01-2021

## STATUT

### **I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

“FREGEN -2020” SHPK Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;
- “Ditë të Plota”, në lidhje me periudhën e një njoftimi, është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

### **Kreu I**

#### **Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia, Forma**

##### **Neni 1**

#### **Emri dhe Forma e Shoqërisë**

Emri i shoqërisë është “FREGEN -2020” SHPK

1.1 SHPK, në vijim referuar si “Shoqëria”.

1.2 Shoqëria themelohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit shqiptar, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi

##### **Neni 2**

#### **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

2.1 Import eksport dhe shitje të mallrave të ndryshëm me pakice dhe me shumice . Import eksport dhe prodhim të të gjitha llojeve të produkteve kozmetike dhe dermokozmetike . Importim, eksportim, tregetim, perpunim me shumice e pakice të bimeve medicinale. Tregetim me shumice e pakice , importim , eksportim me shumice e pakice të artikujve të ndryshëm industrial dhe konsumi , i aparaturave , paisjeve, aksesoreve të ndryshëm mjeksore. Tregetim me shumice dhe pakice , import – eksport i produkteve dhe nenprodukteve mjeksore dhe bime medicinale , perpunim dhe ambalazhim i tyre .

Prodhim dhe tregetim me shumice dhe pakice i konfeksioneve të ndryshme të gatshme dhe gjysem të gatshme , blerje e lëndës së parë , ndihmese , si dhe teknologji , dhe paisje , si dhe ambalazhim e stampimi i tyre .

##### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është për një afat të papërcaktuar.

##### **Neni 4**

#### **Selia, logoja, vula e shoqërisë**

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr , “ Rruga “ Shemsi Haka “ Nr 26 Tirane , kati I-re 9 ndertese private ) Njesia Administrative Nr 1 Tirane të vendosë hapjen dhe mbylljen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit. Logo e Shoqërisë do të jetë “ emri i shoqërisë ”.



4.2 Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj. Vula do të përdoret ekskluzivisht nga Administratori i Shoqërisë.

4.3 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

## **Kreu II**

### **Kapitali i Regjistruar**

#### **Neni 5**

#### **Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë, / njeqind mijë / i ndarë në 2 kuota ,Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm .

Ortakët themelues janë :

- 1) Ortaku themelues : **GRIGOR VASIL GJONI**, datelindjes , 15.06.1975 Tirane banues ne rruga“ Ali Demi “ Tirane dhe me ID H50615072J /, **zoterues i 1 ( nje ) kuote** , me vlere te pergjithshme te kapitalit 50 000 leke, pjesmarrje ne perindje 50% /pesedhejte /
- 2) Ortaku themelues :**GENTJAN FATMIR DOSTI** , lindur ne Tirane me , 11.08.1973 banues e Tirane rruga “ Dhimiter Kamarda “ P 1 Shk 3 ap 59 Tirane me ID H30811035M /, **zoterues i ( 1 ) nje kuote**, me vlere te pergjithshme te kapitalit 50 000 leke , pjesmarrje ne perqindje 50% / pesedhete dhjete /

#### **Neni 6**

#### **Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara**

6.1 Administratori mund t'i kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhtëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

6.2 Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

6.3 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërbëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.





6.4 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

6.5 Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratori konsideron të përshtatshme.

6.6 Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

#### **Neni 7**

#### **Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emëtohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

#### **Neni 8**

#### **Çertifikatat e kuotave**

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në çertifikatën e kuotës. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

#### **Neni 9**

#### **Kalimi me Kontratë i Kuotave**

9.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

9.2 Administratori mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht.

9.3 Nëse Administratori refuzon të regjistrojnë kalimin e kuotës, ai do të njoftojë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

#### **Neni 10**

#### **Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit**

10.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur



nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

10.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

10.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

#### **Neni 11**

### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

11.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

11.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

#### **Neni 12**

### **Blerja e Kuotave të Veta**

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emëtimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori/ët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

### **Kreu III**

### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 13**

### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

13.1 Administratori thërret Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

13.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilët zotërojnë jo më pak se nëntëdhjetë për qind të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me



njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

13.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

#### Neni 14

#### Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

14.2 Administratori cakton Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.

14.3 Nëse Administratori nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

14.4 Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

14.5 Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

14.6 Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

1. Kryetari; ose

2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.

14.7 Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.



14.8 Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

#### Neni 15

#### Votat e Ortakëve

15.1 Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

15.2 Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

#### Neni 16

#### Votimi me Prokurë

Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

#### Neni 17

#### Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklaratë noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

### Kreu IV

#### Administrimi

#### Neni 18

#### Emërimi i Administratorit

Asambleja e Përgjithshme zgjedh një person fizikë si Administratorë të Vetëm të shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjecare, me të drejtë rizgjedhjeje, i cili do të jetë: **Gentjan Fatmir Dosti**, lindur në Tiranë më 11.08.1973 banues në Tiranë rruga "Dhimiter Kamarda" P 1 Shk 3 ap 59 Tiranë me ID H30811035M, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimi do të jetë individualë dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator. Administratori shoqërisë do të jetë e[rfaqësuesi i saj me të tretet, institucionet shtetërore administrative dhe Bankat e Nivelit të dyte



Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorit parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

#### Neni 19

#### Kompetencat e Administratorit

19.1 Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

19.2 Administratori mund t'ua delegojë kompetencat e tij çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosi Administratori dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratori nuk mund të delegojnë detyrimet e tij ligjore.

#### Neni 20

#### Përfundimi i detyrës së Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar në detyrë për më shumë se 6 muaj resht dhe është shkarkuar nga detyra nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

#### Neni 21

#### Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

21.1 Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.

21.2 Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

21.3 Administratorit mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij.

#### Neni 22

#### Procesverbalet e Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme



Administratori kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

#### Neni 23

### **Kontrolli Kontabël i Shoqërisë**

23.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë do të kryhet nga Ekspertët Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të caktojë një ose disa Ekspertë Kontabël të Autorizuar, kur konsiderohet e nevojshme si edhe në ato raste kur emërimi i tyre është i detyrueshëm në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar.

23.2 Mbajtja e librave kontabël të Shoqërisë dhe e dokumentacionit kontabël të saj do të kryhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fushën e të drejtës civile dhe tatimore shqiptare dhe të Statutit të Shoqërisë.

23.3 Në çdo moment, secili nga ortakët do të ketë të drejtë të kërkojë dhe marrë informacion të plotë në lidhje me aktivitetin dhe kontabilitetin e Shoqërisë, si dhe do të ketë të drejtë të shqyrtojë, me shpenzimet e veta, të gjitha regjistrimet dhe dokumentet kontabël të Shoqërisë dhe të kryejë me shpenzimet e veta një kontroll kontabël dhe administrativ të Shoqërisë.

23.4 Përgjegjësia civile, tatimore dhe penale në lidhje me përmbushjen e detyrimeve kontabël dhe tatimore do të jetë në ngarkim të Organit të Administrimit të Shoqërisë.

### **Kreu V**

### **Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### Neni 24

#### **Dividendët**

24.1 Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

24.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

24.3 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

24.4 Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

#### Neni 25

### **Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund



të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

## **Kreu VI**

### **Prishja dhe njoftimet**

#### **Neni 26**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 27**

#### **Njoftimet**

27.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

27.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

#### **Neni 28**

#### **Ligji i Zbatueshëm**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar në përputhje me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar. Ligji nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" do të rregullojë rastet që nuk parashikohen në këtë Statut.

#### **Neni 29**

#### **Gjuha**

Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë.

#### **ORTAKET :**

**""FREGEN -2020"" SHPK"**

#### **Emri dhe nënshkrimi i Ortakëve:**

Grigor Gjoni

GRIGOR. GJONI

Gentjan Dosti

Gentjan Dosti